





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Direkcija za Financije Privreda i Razvoj
Department of Finance Economy and Development

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

Dhjetor 2024

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Plani i punës për vitin 2025 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa do të jetë në harmoni të plotë me planët e punës së Qeverisë Komunale, gjithnjë në respektimin e plotë të Ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë fushëveprimin financiar të kësaj drejtorie siq janë: **Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Ligjin mbi financa të pushtetit lokal, Ligjin për tatimin në Pronën e paluajtshme, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Urdhëresat Administrative si dhe Rregulloret financiare të MF-it** gjegjësisht Departamentit të Buxhetit dhe Thesarit.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, vazhdon të funksionoi edhe gjatë vitit 2025 në dy sektor:

1. Sektori i Buxhetit dhe Financave
2. Sektori i Tatimit në Pronë

1.Sektori i Buxhetit dhe Financave

- Plani i rrjedhës së parasë për të gjitha programet buxhetore,
- Bartja e mjeteve të mbetura (të hyrat komunale) nga viti 2024,
- Raportet periodike tremujore për investime kapitale,
- Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB,
- Rishikimi buxhetor gjashtëmujor 2024 (sipas instruksionit nga MF-ja nëse do të mundësohet),
- Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2025,
- Përgatitja e KAB-it komunal 2026-2028 dhe planifikimi i buxhetit për vitin 2026 komfor Qarkoreve buxhetore nga MF-i si dhe udhëzimeve tjera,
- Përgatitjet dhe aktivitetet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2025,
- Raportet periodike dhe përfundimtare të buxhetit për Kuvendin Komunal dhe dorëzimi në MF,
- Planifikimi i të hyrave sipas llojeve dhe programeve përbrenda komunës, harmonizimi i tyre sipas pozicioneve brenda kufijve të buxhetit të planifikuar – miratuar,
- Raportet mujore për arkëtimin e gjithë të hyrave komunale sipas llojeve dhe programeve,
- Arkëtimet ditore të të hyrave nga taksat dhe tarifat, për shërbimet e ofruara nga komuna,
- Regjistrimi ditor i të hyrave në Free-balance, Sistem i MF-is, dhe nxjerrja e raporteve të nevojshme bankare që pasqyrojnë të hyrat e arkëtuara,
- Barazimet për çdo muaj me drejtoritë komunale, dhe D.eTh. në Ministrinë e Financave,
- Shpërndarja - alokimi për çdo muaj i të hyrave të realizuara sipas pozicioneve buxhetore dhe
- Detyra tjera të dhëna nga Drejtori i Drejtorisë.

Përveç planeve të cekura më sipër **Sektori i Buxhetit dhe Financave** do të jetë në bashkëpunim permanent më MF-in, Departamentin e Buxhetit, për çdo ndryshim eventual me qëllim të ndryshimeve të granteve dhe përfitimeve të Donacioneve të ndryshme stimuluese.

Në mënyre tabelore bartësit e detyrave dhe afatet kohore

Nr.	AKTIVITETI	BARTËSI I AKTIVITETEVE	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT	KOMENTE
1.	Mbyllja e vitit 2024 dhe fillimi i vitit 2025, me buxhetin programor – sipas Drejtorive	DBF. – Evidentimi mbajtja e kontabilitetit sipas Drejtorive	Muaji Janar	Dhe në vazhdimësi gjatë tërë vitit.
2.	Raporti vjetor mbi borgjet e mbetura te komunës për vitin 2024	DBF –Sektori i Adm.Komunale, Arsimit, Shëndetësisë dhe Zyra e Prokurimit	Muaji Janar	Deri më 15.01.2025
3.	Rrjedha e parasë për te gjitha Drejtorit dhe Zyrat Komunale	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji Janar	Në të gjithat Programe buxhetore dhe kategoritë ekonomike
4.	Raporti Financiar për vitin 2024	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji Janar	Aprovimi në Komitet për Politikë dhe Financa dhe Kuvend
5.	Qasja ne Shtypjen dhe shpërndarja e faturave tatimore mbi tatimin në pronë	DBF - Sektori per Tatim e Pronë	Nga muaji Janar	Dhe në vazhdimësi deri në fund të muajit Mars
6.	Përgatitja e Raportit Financiar tremujor Janar-Mars 2025	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji Prill	Duke u bazuar në ligjin mbi Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësit
7.	Mbajtja e evidencës së kontabilitetit : të Hyrave Komunale	DBF - zyrtari i të hyrave komunale	Gjatë vitit fiskal me prerje mujore	Duke bërë barazimet mujore me evidencën e MF-it Departamentit të Thesarit
8.	Rishikimi Buxhetor – 2025 duke u bazuar në kërkesat e secilit Program buxhetor dhe kategori ekonomike	DBF - për secilin program buxhetor	Muaji Maj – dhjetëditëshi i parë	Ndryshimet e mundëshme të cilat janë planifikuar në një pozicion shpenzues ,të rishikohen
9.	Raporti financiar gjashtëmujor për periudhën Janar – Qershor	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave	Muaji Korrik	Duke u nbështetur në barazimet në mes të kontabilitetit dhe Free-Balancit
10.	Përcjellja e realizimit të Buxhetit 2025 ,duke u bazuar procedurat e rregullta të shpenzimeve dhe planifikimit të buxhetit	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave	Gjatë gjithë vitit fiskal buxhetor 2025	Duke u bazuar në Rregulloret financiare të Thesarit

11.	Përgaditja e Buxhetimit Programor për vitin 2026-2028 Për çdo program buxhetor, pas Dëgjimeve buxhetore	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave në koordinim me të gjitha Drejtorit	Gjatë muajit Shtator, dhe aprovimi në fund të muajit	Duke u mbështetur në Qarkoret Buxhetore 2026/01, dhe Udhëzimet administrative.
12.	Bilanci i gjendjës – së regj. të mjeteve themelore dhe i pasurisë në sistemin e Free-Balancit.	Zyrtari për evidentimin e mjeteve themelore dhe të pasurisë	Gjatë gjithë vitit fiskal buxhetor 2024	Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive jo Financiare.
13.	Barazimet e te hyrave dhe shpenzimeve me evidencen e FRE-Balance. Janar – Dhjetor 2025	DBF –Sektori i Buxhetit dhe Financave në koordinim me drejtorin e Arsimit dhe Shëndetësisë.	Fundi i Dhjetorit dhe afati i dorëzimit deri më 15.01.2026	Duke u bazuar në Rregulloret Financiare të Thesarit.

2.Sektori i Tatimit mbi Pronën

2.1. Objektivat e sektorit për Tatim ne Pronë

- Për vitin 2025 parashihen fatura tatimore aktive rreth 6800 me një ngarkesë e cila do të saktësohet në gjysmën e parë të Janarit 2025 atëherë edhe kur do të dalin faturat e para në sistem, ku nga këto fatura sipas planit buxhetor 2025 synohet një realizim prej 344,960.00 € edhe kjo sipas lloje të pronave pronave:

- a) për objekte 278,956.00 €
- b) për parcela toke..... 66,004.00 €.

Normat tatimore të vitit 2024 do të jenë në fuqi edhe për vitin 2025 meqenëse ekzekutivi nuk ka propozua ndryshime për të gjitha llojet e pronave të paluajtshme duke përfshirë edhe parcelat bujqësore për të cilat aplikohet tatimi që nga viti 2024 për herë të parë. Shpërndarja e faturave deri tek obliguesit tatimor do të bëhet në periudhën Janar-Mars. Gjatë viteve paraprake shpërndarja e faturave është bërë me kontratë përmes postës, ndërsa edhe për vitin 2025 pretendohet të vazhdojë në të njëjtën mënyrë.

- Për periudhën Prill-Maj Zyrtari i kërkesave dhe ankesave administrative të TP-së i cili merr vendime për ankesa të cilat bëhen nga ana e obliguesve tatimor, do të bëhen edhe ndryshime me kohë në programin e TP-së me vendimet e Zyrtarit të kërkesave dhe ankesave.

- Gjatë vitit 2025, parashihet që të regjistrohen afërsisht 520 objekte të reja dhe 20% verifikime të pronave ekzistuese me një planë të implementimit me detaj për Zyrtaret për funksionet mbështetëse (klasifikim i pronave, inspektimi i pronave) në teren, të ndarë në lagje të qytetit dhe fshatra. Plani me detaj të veprimave me periudha kohore të dërgohet ekipeve përkatëse të terrenit.

- Lëshuarja e Certifikatave mbi objektet e Patundshmërisë për Qendrën për Punë Sociale (QPS).

- Shpërndarja e njoftimeve përfundimtare për obliguesit e Tatimit ne Pronë, lidhja e marrëveshjeve sipas kërkesave të obliguesve, procedimi me procedura tjera për arkëtim të Tatimit ne Pronë për obligime ne baze të Ligjin për pronën e paluajtshme dhe të Udhëzimit Administrative.

2.2 Strategjia për mbledhjen e detyrueshme të obligimeve tatimore për tatimin në pronë

Kjo strategji duhet të përfshijë disa hapa të strukturuar për të siguruar efikasitet dhe përputhje me legjislacionin në fuqi. Këtu janë disa hapa të mundshëm që mund të implementohen:

Ndërgjegjësimi dhe Informimi i Tatimpaguesve

- Fushata informuese: Organizimi i fushatave për të informuar qytetarët dhe bizneset për detyrimet tatimore, afatet dhe sanksionet për mos-pagimin e tatimit në pronë. Ky informacion mund të shpërndahet përmes mediave, webfaqe-ve të institucioneve tatimore, letrave dhe njoftimeve të drejtpërdrejta.
- Përmirësimi i Shërbimeve të Tatimpaguesve
- Shërbim nëpërmjet zyra të tatimit: Përdorimi i një rrjeti të gjerë zyrash të tatimit për mbledhjen e tatimit në pronë dhe për asistencën e tatimpaguesve.
 - Masa për reduktimin e proceduarve: Sigurimi që procedurat për regjistrimin dhe pagesën të jenë të thjeshta dhe të shpejta, për të inkurajuar njerëzit të paguajnë në kohë
 - Kontrolle dhe inspektime të rregullta: Përdorimi i ekipeve inspektuese për të kontrolluar pronat dhe për të verifikuar nëse janë regjistruar dhe paguar tatimet përkatëse. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e tatimpaguesve që shmangin pagesën e tatimit.
 - Ndjekja e pagesave: Krijimi i një sistemi të koordinuar për ndjekjen e pagesave dhe shtrirjen e mundësive për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura përmes planifikimit të pagesave me këste.
 - Sanksione për pagesat e vonuara: Aplikimi i sanksioneve për ata që nuk paguajnë në afatin e caktuar,
 - duke përfshirë kamatë vonesë dhe mundësinë e sekuestrimit të pasurive për mbledhjen e detyrimit.
 - Rritja e angazhimit të autoriteteve lokale: Bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe përdorimi i sistemeve të regjistrimit të pasurive të patundshme për të përmirësuar saktësinë e informacionit dhe për të mbledhur tatimet e pronës.
 - Pjesëmarrja e komunitetit: Organizimi i aktiviteteve në nivel lokal për të inkurajuar tatimpaguesit të respektojnë ligjin dhe të mbështesin shërbimet publike që financohen përmes këtyre tatimeve.
 - Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë: Publikimi i informacioneve në lidhje me përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga tatimi në pronë dhe rritja e transparencës për mënyrën se si shpenzohen ato.
- Bashkëpunimi Ndërinstitucional
- Bashkëpunimi me agjencitë e tjera: Bashkëpunimi me institucionet që merren me regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe me ato që mbikëqyrin sektorët e tjerë të ekonomisë për të siguruar që të gjitha pronat të regjistrohen dhe taten siç duhet.

Kjo strategji duhet të implementohet në mënyrë të koordinuar për të siguruar që tatimet e pronës të mblihen në kohë, të rrisin përputhshmërinë dhe të minimizojnë evazionin tatimor

2.3. Planifikimi dhe aktiviteti sipas muajve për vitin 2025

	Muaji	Aktiviteti	Planifikimi
1	Janar	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin.	365
2	Shkurt	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350
3	Mars	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	370
4	Prill	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	365
5	Maj	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	400
6	Qershor	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350
7	Korrik	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	300
n 8	Gusht	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	320
9	Shtator	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	370
10	Tetor	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	380
11	Nentor	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	350
12	Dhjetor	Inspektime në teren: verifikime, regjistrime të pronave të reja, verifikime me ankesa, korrigjim i të dhënave të sakta për pronën dhe tatimpaguesin	300
		Gjithsej: aktivitetet ne teren	4220

Skenderaj 11.12.2024



Drejtori për Buxhet dhe Financa
Ismet Aliu